



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Klinë

06. nr. 350 - 2981 / 2014

Klinë, më datën, 16.05.2014.

Në mbështetje të nenit 20 parag. 1 nenëparag. 1.2 i Ligjit nr.04/L-174 për Planifikimin Hapsinor, nenit 8 dhe 9 të Ligjit nr. 03 / L – 230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor-VSM, si dhe duke iu referue përgjegjëseve që dalin nga neni 79 i Statutit të Komunës së Klinës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Klinë, lëshon këtë:

N J O F T I M

Përmes të cilit njoftojm të gjithë qytetaret, grupet e interesit dhe institucionet komunale etj. që nga data 02.06.2014 duke filluar nga ora 10.00h në sallën e Kuvendit Komunal në Klinë, organizohet:

DEBATI PUBLIK

për

Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) për draft Planin Rregullues Urban (PRRU) në Klinë


Qëllimi i shqyrtimit publik është që Draft propozimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Rregullues Urban (PRRU) të Komunës së Klinës, i cili në parim ka marr Pëlqimin nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Klinë, ashtuqë tani për draft dokumentin e tillë të merrën: opinione, sugjerime, komente dhe vërejtje për Vlerësimin Strategjik Mjedisor para se i njëjti plan të procedohet në MMPH-e në Prishtinë në Departamentin e Mbrojtjes së Mjedisit për të marr pëlqimin, dhe me tej të paraqitet për aprovim përfundimtar nga Kuvendi i Komunës.

Të gjithë qytetarëve, grupeve të interesit, bartësve të institucioneve publike në komunë, anëtarve të Kuvendit të Komunës dhe të interesuarve të tjerë, përmes kopjeve të draft dokumentit të punuar nga Kompania „INSI,, me seli në Prishtinë dhe përmes këtij debatit iu mundsohet që të kontribuojnë në dhenjen e komenteve, sugjerimeve, vërejtjeve, mendimeve profesionale apo keshillave përkatëse të cilat do të jenë me interes për dokumentin final dhe për të gjithë qytetaret dhe banoret e Komunës së Klinës.

Komentet në formë të shkruar apo çfardo forme tjetër e kontributit të arritur mund të dërgohen në Drejtorin për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Klinë si autoritet përgjegjës draft Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor-VSM, Raportin e pjesëmarrjes së publikut dhe të debatit publik si dhe dokumentet tjera përcjellëse do të ia dergoj Ministrisë së Planifikimit Hapsinor-Departamentit të Planifikimit Hapsinor në Prishtinë për marrjen e PELQIMIT për Raportin e VSM-or para se i njëjti të i dërgohet Kuvendit Komunal për shqyrtim dhe miratim përfundimtar (neni 12 i Ligjit nr.03/L-230).

Draft dokumenti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) në Planin Rregullues Urban (PRRU) të Komunës së Klinës, mund të merret në Drejtorin për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Klinë dhe i njëjti dokument do të mund të gjindet dhe shkarkohet edhe nga ueb faqja zyrtare e Komunës së Klinës, kk.rks-gov.net/klina/.

Njoftimi i tillë publikohet në: Tabelën komunale të shpalljeve, në ueb faqën zyrtare të komunës kk.rks-gov.net/klina/, pastaj në shtypin e përditshëm, një kopje i dërgohet MMPH-or në Prishtinë-Departamentit të Planifikimit Hapsinor si dhe një kopje i mbetet arhivës komunale.

D r e j t o r i:

z. Baki Gashi

